



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 143, datë 26.07.2019

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E LARTË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues:{...}; me objekt: “Ekstradim të të dënuarit {...}në Itali me qëllim ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim të dhënë ndaj tij nga Gjykata e Milanos, Itali, (i formës së prerë).

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues:{...}; me objekt: “Miratimi i lejimit ekstradimit të shtetasit shqiptar {...}nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, si dhe zgjatjen e masës së sigurimit “arrest në burg me afat 40 ditë”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues:{...}; me objekt: “Ekstradimin nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Lartë, çështjen gjyqësore me rekursues: {...}; me objekt: “Lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, {...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; me objekt: “Sigurim prove për marrjen e dëshmisë së shtetasës {...} lidhur me procedimin penal nr.209 të vitit 2019 regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 101/1 e 121/a/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJE

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, çështjen penale me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; në ngarkim të të pandehurve: {...}; të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 76 e 22 dhe 25 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; me kallëzuese: {...}; shtetasit në hetim: {...}, etj; të kallëzuar për veprën penale: “Falsifikim i dokumentave”; me objekt të kërkesës: “Pushimin e çështjes penale nr.547, datë 13.07.2018”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PËRMET

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, çështjen gjyqësore me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet; të pandehur: {...}; me objekt: “Rivlerësim mase mjekësore të caktuar ndaj të gjykuarit {...}”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

